



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

Kuvendi i Komunës Klinë

01Nr. 06-9252 /2026

Datë: 01/04 /2026

Duke u mbështetur në nenin 12 paragrafi 12.2 shkronjën d) dhe nenit 40. paragrafi 40.2 shkronjën c) dhe l) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale 03/L-040. Nenit 10 pikën 4) dhe Nenin 40 pikën 11 të Statutit të Komunës së Klinës i miratuar në Mars 2010, me kërkesën e Drejtorisë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi të datës: 02.03.2026 me nr. prot-01Nr.351-6270/2026, si dhe me Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa të datës 18.03.2026, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e III-të të rregullt për vitin 2026 të mbajtur me 27.03.2026, mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi për ndërrimin e titullarit të pronave, sipas të dhënave dhe dokumentacionit të paraqitur në kërkesë.
2. Prona e cila, sipas certifikatës së pronësisë me numër të lëndës 11-293-2026-2, të datës 13.02.2026, evidentohet P.SH. ORGANIZATA P. NDËRTIMORE ZEJTARE B., parcela me nr.: P-71006024-00410-2, në sipërfaqe prej 23653 m², dhe pronat të cilat, sipas certifikatës së pronësisë me numër 11-293-2026-1, të datës 13.02.2026, evidentohen BASHKËSIA V. INTERISTIT PËR BAHIM, parcelat: P-71006024-00516-1 në sipërfaqe prej 1836 m², O-71006024-00516-1-1-0 në sipërfaqe prej 415 m², P-71006024-00517-1 në sipërfaqe prej 480 m², P-71006024-00517-3 në sipërfaqe prej 160 m², pas konfirmimit të ligjshmërisë së vendimit, regjistrohen prona shoqërore në emër të Komunës së Klinës.
3. Ndërrimi i titullarit të pronës bëhet me qëllim të interesit publik, shfrytëzimit dhe zhvillimit të projekteve të cilat janë në interesin publik.
4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Kryetari i Komunës në bashkpunim me Drejtorin për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi.
5. Vendimi hynë në fuqi pas miratimit nga ana e Kuvendit, bazuar në Ligjin Nr.08/L-284, si dhe pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- MAPL;
- Kryetari i Komunes;
- Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi;
- Zyra për Informim;
- Arkivi.



Kryesues i Kuvendit
Enver Berisha